

Shkaqet për arritjen e rizikut

Prej Emrave të Allahut është err Rrezak - Furnizuesi. Kjo tregon se furnizimi është në Dorën e Allahut. Ai ka marrë përsipër furnizimin e robërve të Tij. Mirëpo, Allahu ka caktuar shkaqe për furnizimin, të cilat i ka sqaruar në Kuran dhe në sunetin profetik. Prej shkaqeve për arritjen e rizikut janë:

- **Besimi në Allahun, veprat e mira dhe frika ndaj Tij.** Allahu thotë: "**Për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, ka falje dhe furnizim të bollshëm.**" Haxh 50. Dhe thotë: "**Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t'i gjejë rrugëdalje (nga çdo vështirësi) dhe do t'i japë risk prej nga nuk e pret. Allahu i mjafton kujtdo që mbështetet tek Ai. Allahu e përmbush me siguri vendimin e Tij dhe për çdo gjë Ai ka caktuar masë.**" Talak 2-3.

- **Mbështetja e vërtetë në Allahun**, në mënyrën më të mirë e të saktë, duke ia dorëzuar e besuar Atij të gjitha çështjet, me besim e bindje të plotë në Allahun. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: "***Sikur ju t'i mbështetëshit Allahut ashtu siç e meriton Ai, Ai do t'iu furnizonte siç i furnizon shpendët të cilët dalin në mëngjes me barkun e zbrazur dhe kthehen në mbrëmje me barkun e mbushur.***"

-**Durimi.** Ai është çelësi i lehtësimit prej Allahut, është dera përmes së cilës hyn njeriu dhe i lehtësohen çështjet. Mirëpo, durim me tri llojet e tij: durim në Urdhrat e Allahut duke i zbatuar, durim në ndalesat e Allahut duke iu larguar dhe durim në fatkeqësitë e sprovat nga

Allahu. Allahu thotë: "**Vetëm ata që janë të durueshëm, do të shpërblehen pa masë.**" Zumer 10.

-Lutja tek Allahu për furnizim. Lutja tek Allahu është çelësi i të mirave në të dy botët. Pa dyshim se nëse njeriu dëshiron furnizim për vetën e tij duhet ta lusë Allahun vazhdimisht me këmbngulje e të mos heqë dorë prej lutjes. Atij të cilit Allahu ia ka mundësuar të bëjë lutje, nuk e privon nga përgjigja e saj. Allahu nuk e refuzon robin e Tij kur ai e thërret Atë dhe i lutet Atij. Allahu nuk e zhgënjën besimtarin kur ai bisedon fshehtas me Të dhe kërkon nga Ai. Allahu ka thënë: "**Zoti juaj ka thënë: "Lutmuni Mua, se do t'ju përgjigjem!"**" Gafir 60. Dhe ka thënë: "**Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thujaju se) Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua.**" Bekare 186. Dhe: "**Vërtet, Zoti im i dëgjon lutjet!**" Ibrahim 39. Kuptimi është: i përgjigjet të gjitha lutjeve. Çdo mirësi që e dëshiron në këtë botë dhe në tjetrën, së pari duhet ta kërkojë përmes lutjes tek Allahu. Dhe pa dyshim këtu hyn edhe rizku, për të cilin jemi duke folur. Allahu tregon për besimtarët të cilët janë lutur: "**dhe na jep mirësi, se Ti je Dhuruesi më i mirë!**" Maide 114.

Për atë që ka borxhe

Ai që ka borxhe dhe kthehet tek Allahu me lutje të sinqert, Ai ia mundëson shlyerjen e tyre. Transmetohet se një prej robërve ka qenë rob i cili e ka blerë veten e tij prej zotërisë së tij. Allahu ka urdhëruar (atëherë kur kishte robër) që nëse robi kërkon nga zotëria i tij ta blejë

veten e tij përmes punës, ai e ka për obligim t'i përgjigjet kësaj kërkesë të robit. Ai ka ardhur te Aliu radijAllahu anhu dhe i ka thënë: *"Nuk po kam mundësi ta blej veten time (të punoj për ta fituar lirinë). Më ndihmo me çfarë të kesh mundësi!"* Aliu i thotë: *"A dëshiron të t'i mësoj disa fjalë të cilat vetë Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem m'i ka mësuar mua, që edhe nëse ke borxh sa mali Sirë (mal i madh), Allahu ta mundëson ta paguash atë? Thuaj: " اللَّهُمَّ اكْفِنِي بِحَلَالِكَ عَنْ سِوَاكَ وَأَعْنِنِي بِفَضْلِكَ عَمَّنْ سِوَاكَ - O Allah, më mjafto me hallallin Tënd ndaj haramit Tënd* dhe më jep prej mirësive Tua që të mos kem nevojë për të tjerët!"** Tirmidhiu. Nëse lutesh me këtë lutje me bindje të plotë në Allahun, Ai ta mundëson larjen e borxheve.

Kur merr borxh njeriu, duhet të ketë qëllim të mirë e të sinqert që ta kthejë atë, duke e marrë atë borxh si ndihmesë për një periudhë të caktuar e pastaj ta kthejë. Nëse e merr atë me qëllim të keq, Allahu ia shkatërron pasurinë. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: *"Kush merr pasurinë e njerëzve (borxh) me qëllim ta kthejë atë posa të ketë mundësinë, Allahu do ta shlyejë atë borxhë për të (d.m.th. Ai e merr përsipër). Dhe kush merr pasurinë e njerëzve me qëllim t'i shpenzojë e të mos ua kthejë kurrë, Allahu ka për ta shkatërruar atë dhe pasurinë që e ka marrë."* Buhariu. Dhe ka thënë: *"Çdo njeri i cili ka qëllim të mirë për ta larë borxhin (të mos e vonojë), Allahu ka për ta ndihmuar atë (ta lajë atë)." Imam Ahmedi.*

*Më mjafto me gjërat e lejuara që të mos kem nevojë për gjëra të ndaluara.

* Që të mos kem nevojë të kërkoj prej krijesave.

-Falënderimi e mirënjohja ndaj Allahut për të mirat që na ka dhënë. Nëse njeriu është mirënjohës, atëherë ky falënderim është si lloj kujdesi e ruajtje e mirësive që i posedon. Falënderimi ndaj Allahut përveç që t'i ruan mirësitë të cilat i ke pran vetes, po ashtu t'i shton ato që nuk i ke, që i dëshiron. Mjafton si argument për këtë Fjala e Allahut: "(Kujtoje) kur Zoti juaj kumtoi: "Nëse tregoheni mirënjohës, Unë do t'ju shtoj edhe më shumë begatitë e Mia, por nëse ju mohoni mirësitë e Mia, (atëherë dijeni se) dënimi Im është i rëndë". Ibrahim. 7.

- Kthimi tek Allahu me pendim të sinqertë dhe kërkim falje prej Tij. Allahu është el Gaffar el Gafur - Falës i Madh, është Et Tewwab - Ai që pranon pendimin. Ky është prej shkaqeve për shtimin e rizkut dhe të gjitha mirësive të tjera. Allahu thotë: **"...të kërkoni falje nga Zoti juaj e të ktheheni tek Ai me pendesë. Ai do t'ju japë të shijoni kënaqësi të bukur..."** Hud 3. Dhe thotë se Profeti Nuh ka thënë: **"...e u thashë: "Kërkoni falje nga Zoti juaj, i Cili është Falës i madh, që Ai t'ju dërgojë shi të bollshëm, t'ju shtojë pasurinë dhe fëmijët tuaj dhe të bëjë për ju kopshte e lumenj!"** Nuh 10-12. Kur një person i është ankuar te Hasan el Basriu rahimehullah se nuk po ka shira të bollshëm, i ka thënë: **"Kërko falje tek Allahu!"** Ka ardhur një tjetër e i ka thënë se është i

varfër, i ka thënë: "*Kërko falje tek Allahu!*" Ka ardhur i treti i ka thënë se nuk ka fëmijë, e ai i ka thënë: "*Kërko falje tek Allahu!*" I katërti i ka thënë se kopshti nuk i jep fruta të bollshëm dhe i ka thënë: "*Kërko falje tek Allahu!*" Të pranishmit e kanë pyetur Hasan el Basriun se pse të gjithëve u the njëjtë: "*Kërko falje tek Allahu!*", ka thënë: "*Nuk kam shtuar më shumë përveç asaj që ka thënë Allahu.*" Pastaj ka lexuar këto ajete të mësipërme të sures Nuh.

- **Mbajtja e lidhjeve farefisnore.** Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: "*Kush dëshiron shtimin e rizkut dhe të jetës, le t'i mbajë lidhjet farefisnore.*" Buhariu dhe Muslimi.

- **Dhënia.** Nëse jep sa më shumë lëmoshë e u ndihmon të tjerëve, dije se kjo do të ta shtojë pasurinë, rizkun dhe të mirat, që është e kundërta nga ajo që mendojnë njerëzit duke i cytur shejtani se nëse japin do t'u pakësohet pasuria. Por, Allahu dhe Pejgameri i Tij na kanë mësuar se nëse japim, Allahu na shton. Allahu thotë: "**Ai ua zëvendëson atë që e ndani ju; Ai është Dhuruesi më i mirë.**" Sebe 39. Qëllimi me "ua zëvendëson" është: ua shton, sepse kur Allahu ua zëvendëson u jep shumë fish. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: "*Asnjë lëmoshë nuk e pakëson pasurinë.*" Nuk ka ndodhur e as që do të ndodhë që lëmosha ta pakësojë pasurinë, përkundrazi ajo e shton atë.

-**Bërja sa më shpesh e haxhit dhe umres.** Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: "*Pasojeni haxhin me umre dhe umren me haxh...*" Pra e kryen haxhin,

dhe pas haxhit shkon për umre. Pastaj pas umres shkon për haxh. *"...ngase haxhi dhe umreja largojnë prej jush varfërinë dhe mëkatet..."*

-**Martesa dhe fëmijët e shumtë.** Këtë na ka premtuar Allahu. Ai thotë: **"I martoni të pamartuarit dhe të pamartuarat ndër ju, si dhe skllëvërit dhe skllavet tuaja që janë besimtarë të ndershëm! Nëse janë të varfër, Allahu, do t'i begatojë ata me dhuntinë e Tij..."** Nur 32. Dhe thotë: **"Mos i vrisni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë"** Isra 31. Kjo përveç që tregon se çfarë kanë vepruar idhujtarët e Mekës, të cilët i kanë mbytur vajzat e tyre për së gjalli nga frika se sjellin varfëri në të ardhmen, përfshin edhe ata që bëjnë planifikim familjar për shkak të frikës nga varfëria, se nuk do të kenë mundësi t'i furnizojnë fëmijët. E Allahu thotë të mos i vrisni fëmijët nga frika e varfërisë. Pse? Vazhdon ajeti: "Ne u sigurojmë ushqim atyre dhe juve." Së pari fillon me "atyre", me fëmijët.

-Bërja hixhret për hir të Allahut. Në shumë vende në Kuran e përmend Allahu këtë gjë. Thotë: **"Kush mërgon për çështjen e Allahut, ai gjen shumë vendbanime dhe begati në tokë."** Nisa 100.

- **Zgjimi herët (mosfjetja në mëngjes).** Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: "O Allah, jepi bereqet umetit tim në fillimin e ditës (mëngjesin e hershëm)!" Tirmidhiu. Mëngjesi i hershëm (arabisht: bukuur) është pasi falet sabahu derisa të lindë dielli. Ibn Kajjim rahimehullah ka thënë: *"Ai që fle në mëngjes e privon veten prej rizikut ngase kjo është koba kur ndahet riziku mes*

kerjesave." Zatul mead. Tregohet se Ibn Abbasi ka parë njërin nga bijt e tij duke fjetur në këtë kohë dhe i ka thënë: "*Zgjobu! Si flenë në një kohë kur ndabet rizku mes kerjesave?!"*

- **Ndihma ndaj të tjerëve.** Sa më shumë që u ndihmon të tjerëve, Allahu të ndihmon ty. Ky është premtim prej Allahut. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: "**Allahu e ndimon robin e Tij për aq sa ai e ndihmon vëllanë e tij.**" Ibn Kajim tregon për ibn Tejmije rahimehullah se duke e ditur këtë fakt u ka ndihmuar shumë njerëzve, ka qenë gjithmonë në shërbim të tyre, se e ka ditur se nëse iu ndihmon atyre patjetër ka për ta ndihmuar Allahu atë. Dhe e dimë se çfarë jete e dije të bereqetshme ka pasur ai.

-Veprimi (punimi). Allahu e ka bërë shkak për fitimin e rizkut përpjekjen, lëvizjen, e jo të jemi dembelë. Allahu thotë: "**...ecni nëpër viset e saj dhe ushqehuni me atë, që ju ka dhënë Ai.**" Mulk 15. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selam ka thënë: "***Kujdesu për gjërat që të bëjnë dobi (pra merri shkaqet) dhe kërko ndihmën e Allahut.***" Këto dy gjëra duhet të shkojnë bashkë.

- **Shtimi i salavateve për Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem.**

[

Hoxhë Lulzim Perçuku - Dersi) **Shkaqet për arritjen e të mirave në këtë botë dhe në ahiret.**